



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 174, Datë 26.10.2017

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1 gërma “d”; 13 të “Rregullores për Procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me shkresën e datës 06.09.2017, protokolluar në ERE me nr. 605 Prot., datë 06.09.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

Bordi i ERE me vendimin nr. 148, Datë 28.09.2017, ka vendosur për mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i Shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a/b”, “c” “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a” “b”, “c”, “e”, “f”, “a.1”, “b.1”, “c.1”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5- vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI